

VENDIM
Nr. 47, datë 20.3.2020

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHKURT 2020**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 20.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e datës 17.3.2020, si dhe relacionin shtesë, të datë 19.3.2020 përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin shkurt 2020,

Konstatoi se:

- FSHU sh.a., me shkresën nr. 2877 Prot., datë 9.3.2020 dhe me anë të emailit të datës 19.3.2020 ka paraqitur e në vijim plotësuar, aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shkurt 2020.

- Nisur nga deklaratimet e FSHU sh.a., analizës së të dhënave në këtë aplikim në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë nga tregu i parregulluar, si dhe kurseve zyrtare të këmbimit bazuar nga publikimet e Bankës së Shqipërisë, ka rezultuar çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar për muajin shkurt 2020 prej 6.269 lek/kWh.

- Në analizën e dokumentacionit të aplikimit që shoqëria FSHU sh.a., ka depozituar në ERE, evidentohet se për përcaktimin e Kostove Administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, aplikuesi i ka vlerësuar si vijon:

Shpenzime Operative	0.54 lekë/kWh
Kosto e Borxhit të keq	0.66 lekë/kWh
Kompensimi për Humbjet	0.59 lekë/kWh
Kosto Administrative Gjithsej	1.79 lekë/kWh

- FSHU sh.a., deklaroi se për llogaritjen e çmimit FMF gjatë vitit 2019 është përdorur metoda e llogaritjes së kostove administrative për njësi të shitur për kWh, dhe meqenëse ERE nuk është shprehur ende me vendim bazuar në aplikimin e paraqitur nga FSHU sh.a., për çmimet e shitjes të energjisë elektrike me pakicë për vitin 2020, FSHU sh.a., propozon që për llogaritjet lidhur me Kostot Administrative të vitit 2019 të aplikohen edhe për muajt e parë të vitit 2020.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019 të bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020” është 1.5 lekë/kWh.

- Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë lekë/euro të ditëve kur shoqëria ka realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si

dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin shkurt 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon.

Çmimi i FMF-së për muajin Shkurt 2020				
Shkurt 2020			Aplikimi FSHU sh.a.	Propozimi i ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.269	6.269
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.19	0.19
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	6.46	6.46
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të njetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të njetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	10.50	10.50

-Për sa përcaktuar për çdo element të formulës llogaritëse rezulton që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2020 të jetë **10.50 lekë/kWh**.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 10.50 lekë/kWh për muajin shkurt 2020.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti